



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 4244/1, Prot.

Tiranë, më 31.07.2025

Lënda: Kthim përgjigje

Z. DORIAN MATLIJA

QENDRA “RES PUBLICA”

E-mail: gendra.respublica@gmail.com

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion nr. 88/25 prot., datë 24.07.2025, regjistruar me numër rendor 32 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe me aktin nr. 4244 prot., datë 24.07.2025, në të cilën kërkon vënien në dispozicion të shkresës së Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) me nr. 16 prot., datë 17.01.2022, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Neni 179/b, pika 8 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: “Mandati i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik përfundon në datën 31.12.2024, ndërsa mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Apelimit është 9 vjet. Pas shpërbërjes së komisionit, çështjet e papërfunduara të rivlerësimit shqyrtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas ligjit..”. Gjithashtu, neni 70 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se: “1. Institucionet e rivlerësimit pushojnë së funksionuari sipas nenit 179/b, pika 9, të Kushtetutës. 2. Përveç rasteve kur autorizohet ndryshe nga Kuvendi, mandati i vetëm që vazhdon është ai i Sekretarit të Përgjithshëm, i cili ka një personel të mjaftueshëm për të përmbushur detyrat”.

Ndërsa në nenin 171, pika 5, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, parashikohet se: “5. Pas vlerësimit të aftësive profesionale, të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Apelimit, në rast se është ushtruar e drejta e ankimit, i dërgon Këshillit dosjen me vlerësimin e kryer të magjistratit, çdo dokument të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Nëse magjistrati kalon me sukses procesin e rivlerësimit, Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerësimit përkatës”.

Gjithashtu, në nenin 19, pika 4 të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar, parashikohet se: “Arkivi Qendror Shtetëror i Drejtësisë ruan, përpunon,

administron dhe shërben të gjitha dokumentet gjyqësore dhe hetimore-penale të krijuara të të gjitha shkallëve të sistemit të drejtësisë, si dhe dokumentet në funksion të vendimmarrjes së procesit të rivlerësimit të kryer nga organet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

Sa më sipër, ju bëjmë me dije se, bazuar në parashikimet ligjore të sipërcituara, organet e rivlerësimit kalimtar përcjellin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor vetëm dokumentacionin përkatës mbi gjyqtarët të cilët kanë kaluar me sukses këtë proces. Ndërsa lidhur me dokumentacionin e kërkuar nga ana juaj mund të drejtoheni pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, i cili vijon të ushtrojë funksionet e tij, ose pranë Arkivit Qendror të Sistemit të Drejtësisë.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

RUDIN BAQLI

